

VENDIM
Nr.726, datë 1.7.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS ULËZ TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Ulëz të qarkut të Dibrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 63 (gjashtëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 427 (katërqind e njëzet e shtatë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Ulëz për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Ulëz

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
12-16	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
1	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
8-11	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
2-7	Varrezat publike	Në pronësi
369-378	Infrastrukturë (rugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike.	Në pronësi
379-382,383,386-388,391,392,395	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
361-363,365,367 (vetëm kanalet e treta) 380,381,384,385,389,390,	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi

393,394,396		
397,398	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
426,427	Prona që përdoren në fushën e energjetikës.	Në pronësi